FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.40 15 prill 2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.163, datë 3.3.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.854, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe në atë të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës", të ndryshuar	1457
Vendim i KM nr.164, datë 10.3.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për mbulimin e shpenzimeve të qirasë së zyrave të misionit EURALIUS	1458
Vendim i KM nr.167, datë 10.3.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluatjshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Kukës të qarkut të Kukësit	1459
Vendim i KM nr.169, datë 10.3.2010	Për një shtesë në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit", të ndryshuar	1460
Vendim i KM nr.170, datë 10.3.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e atasheve ushtarakë, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shërbejnë në përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në shtabet e NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare", të ndryshuar	1460
Vendim i KM nr.171, datë 10.3.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i kalatës së Limjonit të Portit Sarandë sh.a	1461

Vendim i KM nr.172, datë 10.3.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të shërbimit të anijeve detare dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë "Anijet e shërbimit detar" sh.a.....	1462
Vendim i KM nr.173, datë 10.3.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për ndërhyrjet emergjente në objektet e mbrojtjes nga përmbytja dhe digat e rezervuarëve	1463
Vendim i KM nr.174, datë 18.3.2010	Për pjesëmarrje në operacionin ushtarak NTM-I (NATO Training Mission Iraq)	1464
Vendim i KM nr.177, datë 10.3.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë private "Sevasti & Parashqevi Qiriazi", Tiranë	1465
Vendim i KM nr.178, datë 10.3.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë private "Kristal", Tiranë	1466
Vendim i KM nr.181, datë 17.3.2010	Për mënyrën e organizimit e të funksionimit dhe për përbërjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore	1467
Vendim i KM nr.182, datë 10.3.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 686, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës", të ndryshuar ...	1469
Vendim i KM nr.183, datë 10.3.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.71, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, në njësitë e qeverisjes qendrore"	1469
Udhëzim i MPÇSSHB nr.423, datë 24.2.2010	Për kriteret e përdorimit të fondit të pashpërndarë të mbrojtjes sociale	1473
Udhëzim i MD dhe METE nr.2007/1, datë 2.3.2010	Për rastet kur noterët kërkojnë informacion të shkruar mbi të dhënat e regjistrit të barrëve siguruese dhe procedurat që ndiqen në këto raste	1479
Vendim i BSH nr.13, datë 10.3.2010	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.....	1481

VENDIM
Nr.163, datë 3.3.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.854, DATË 5.8.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE DHE NË ATË TË MJEKËSISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Më vendimin nr.854, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) fjalët "… për vitin 2009…" zëvendësohen me "…për vitin akademik 2009-2010…".

ii) Shkronjat "A" dhe "B" ndryshohen, si më poshtë vijon:

"A. Fakulteti i Shkencave Sociale:

a) Doktoratë në filozofi	24;
b) Doktoratë në sociologji	34;
c) Doktoratë në pedagogji	19;
ç) Doktoratë në psikologji	23;
d) Doktoratë në punë sociale	20.

B. Fakulteti i Mjekësisë:

a) Doktoratë në studime të thelluara në farmakologji, fiziologji, fiziologji patologjike	10;
b) Doktoratë në studime të thelluara të aspekteve epidemiologjike, diagnostike dhe terapeutike të sëmundjeve infektive, emergjente dhe riemergjente	17;
c) Doktoratë në shëndet publik	16;
ç) Doktoratë në studime të thelluara të aspekteve epidemiologjike, diagnostike dhe terapeutike të sëmundjeve të lëkurës	13;
d) Doktoratë në studime të thelluara dhe kërkime në otorinolaringologji	10;
dh) Doktoratë me studime të thelluara në kardiologji	19;
e) Doktoratë në studime në patologji oro-maxilo-faciale	43;
ë) Doktoratë në studime në neuroshkencë	23;
f) Doktoratë në studime në obstetrikë-gjinekologji	17;
g) Doktoratë në mjekësi laboratorike	26;
gj) Doktoratë në morfologji klinike	17;
h) Doktoratë në sëmundjet kirurgjikale	48;
i) Doktoratë në kardiokirurgji	4;
j) Doktoratë në imazheri	14;
k) Doktoratë në anatomi patologjike dhe mjekësi ligjore	14;
l) Doktoratë në sëmundjet e syrit	16;
ll) Doktoratë në pediatri	30;
m) Doktoratë në shkencat farmaceutike	13;
n) Doktoratë në sëmundjet e brendshme	28.".

b) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.".

c) Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

"6/1. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.".

2. Nga kuotat e mësipërme të këtyre programeve të studimit caktohet 10 (dhjetë) për qind për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.164, datë 10.3.2010

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË QIRASË SË ZYRAVE TË MISIONIT EURALIUS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të neneve 3.1 dhe 5 të shtojcës së marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin vjetor të veprimit CARDS 2006 për Shqipërinë", e ratifikuar me ligjin nr.9671, datë 29.12.2006, dhe të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t'i shtohet fondi prej 2 334 004 (dy milionë e treqind e tridhjetë e katër mijë e katër) lekësh për pagesën e qirasë së zyrave të misionit EURALIUS, në zbatim të marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin vjetor të veprimit CARDS 2006 për Shqipërinë".

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.167, datë 10.3.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUATJSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KUKËS TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Kukës të qarkut të Kukësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 124 (njëqind e njëzet e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 794 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Kukës Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1,2,3,4,5,35,36,37,41, 42,43	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
59-69	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
97,99-106	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore e sportive.	Në pronësi
127-130	Prona që përdoren për shërbime sociale.	Në pronësi
220-222	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
223,224-246	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
248-254	Shërbim funeral	Në pronësi
255	Prona që përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm.	Në pronësi
257-402	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
403-518	Infrastrukturë sheshe dhe lulishte.	Në pronësi
519-756,761,762,763, 765,784	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile.	Në pronësi

VENDIM
Nr.169, datë 10.3.2010

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet emërtesa "Agjencia Kombëtare Bërthamore".

2. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës të Agjencisë Kombëtare Bërthamore të përcaktohen sipas vendimit për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare, për vitin 2010, të përballohen nga fondet e planifikuara për Agjencinë Kombëtare Bërthamore për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.170, datë 10.3.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.90, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E ATASHEVE USHTARAKË, TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSINË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-S, NË SHTABET E NATO-S, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

a) Në titullin e vendimit, pas fjalëve, "… të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Republikës së Shqipërisë…", shtohen fjalët "…dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes… .".

b) Në paragrafin e parë të pikës 1, pas fjalës "…ushtarakët…", shtohen fjalët "dhe punonjësit civilë të Ministrisë së Mbrojtjes, vetëm në rastet kur në strukturë parashikohet përfaqësimi i barasvlershëm me një ushtarak me gradë të caktuar, …".

c) Në pikën 2, pas fjalës "…ushtaraku…", shtohen fjalët "…dhe punonjësi civil i Ministrisë së Mbrojtjes, vetëm në rastet kur në strukturë parashikohet përfaqësimi i barasvlershëm me një ushtarak me gradë të caktuar … ".

ç) Në pikën 3, pas fjalëve "… nga data e mbërritjes së ushtarakut…", shtohen fjalët "…apo punonjësit civil të Ministrisë së Mbrojtjes … ".

d) Në pikën 4, pas fjalës "…Ushtaraku …", shtohen fjalët "…dhe punonjësi civil i Ministrisë së Mbrojtjes, vetëm në rastet kur në strukturë parashikohet përfaqësimi i barasvlershëm me një ushtarak me gradë të caktuar …".

dh) Në pikën 7, pas fjalëve "…Pagesat për ushtarakët…", shtohen fjalët "…si dhe për punonjësit civilë të Ministrisë së Mbrojtjes, … ".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.171, datë 10.3.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I KALATËS SË LIMJONIT, TË PORTIT SARANDË SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i kalatës së Limjonit, të Portit Sarandë sh.a.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Portit Sarandë sh.a.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) m^2, tokë truall, dhe objekt, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 7 321 870 (shtatë milionë e treqind e njëzet e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 225 200 (dyqind e njëzet e pesë mijë e dyqind) lekë, të përballohen nga Porti Sarandë sh.a.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 7 321 870 (shtatë milionë e treqind e njëzet e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë, "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 15.3.2010 dhe të përfundojë më 15.6.2010.

7. Pronari i përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë drejtorisë së Portit Sarandë sh.a.

8. Porti Sarandë, sh.a, të kryejë verifikimet lidhur me përputhshmërinë e sipërfaqeve, të cilat preken nga ndërtimi i kalatës, me numrin e pasurisë, në pronësi të pronarit, që shpronësohet.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Porti Sarandë sh.a, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË KALATËS SË LIMJONIT, SARANDË

Nr.	**Emri**	**Atësia**	**Mbiemri**	**Zona kadast.**	**Nr. pas.**	**Ndërtesë sip m²**	**Çmimi lekë/ m²**	**Vlera lekë/ m²**	**Truall m²**	**Çmimi lekë/ m²**	**Vlera lekë/ m²**	**Vlera totale lekë**	**Shënime**
1	Niko	Spiro	Llajo	8641	1	100					4 533 550	4 533 550	Proces regjistrimi
2	Niko	Spiro	Llajo	8641	1				160	17.427	2 788 320	2 788 320	Proces regjistrimi
Shuma	Niko	Spiro	Llajo									**7 321 870**	

VENDIM
Nr.172, datë 10.3.2010

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË SHËRBIMIT TË ANIJEVE DETARE DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË "ANIJET E SHËRBIMIT DETAR" SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 5, pikat 1 e 3, e 23, pika 3, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës ROT (Rehabilitim-shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit), të shërbimit të anijeve detare, është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Miratimin e bonusit prej 7 % të pikëve, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "Anijet e shërbimit detar" sh.a.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.173, datë 10.3.2010

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, PËR NDËRHYRJET EMERGJENTE NË OBJEKTET E MBROJTJES NGA PËRMBYTJA DHE DIGAT E REZERVUARËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri "Investime", t'i shtohet fondi prej 229 000 000 (dyqind e njëzet e nëntë milionë) lekësh për ndërhyrjet emergjente në objektet e mbrojtjes nga përmbytja dhe digat e rezervuarëve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E OBJEKTEVE PËR NDËRHYRJET EMERGJENTE NË OBJEKTET E MBROJTJES NGA PËRMBYTJA DHE DIGAT E REZERVUARËVE

Nr.	**Emërtimi i objektit**	**Vlera në milionë lekë**	**Bordi i kullimit**
	Objekte të mbrojtjes nga përmbytja		
1	Mbrojtje nga lumi Drin në Ashtë, Shkodër	6	Shkodër
2	Mbrojtje nga lumi Devoll në fshatin Vlashuk, Kuçovë	15	Berat
3	Thellimi i shtratit të lumit Devoll (Ura e Maliqit), Korçë	50	Korçë
	Digat e rezervuarëve (rehabilitimi i shkarkuesve katastrofik dhe ujëlëshuesve)		
4	Diga e rezervuarit Shqefen, Mat	9	Mat
5	Diga e rezervuarit Suhbull, Mat	9	Mat
6	Diga e rezervuarit Midhës, Mat	3	Mat
7	Diga e rezervuarit Kurjan, Fier	2.5	Fier
8	Diga e rezervuarit Lumara 1+2, Fier	6	Fier
9	Diga e rezervuarit Turbullt, Fier	3	Fier
10	Diga e rezervuarit Zallher, Tiranë	5	Tiranë
11	Diga e rezervuarit Marikaj, Tiranë	2	Tiranë
12	Diga e rezervuarit Shtoder, Shkodër	5	Shkodër
13	Diga e rezervuarit Staraveckë, Berat	1.5	Berat
14	Diga e rezervuarit Rogu, Berat	1.5	Berat
15	Diga e rezervuarit Allambrez, Berat	1.5	Berat
16	Diga e rezervuarit Slanicë, Berat	1.5	Berat

17	Diga e rezervuarit Duhanas, Berat	1.5	Berat
18	Diga e rezervuarit Kalivaç, Gjirokastër	2.5	Gjirokastër
19	Diga e rezervuarit Komarit, Tepelenë	2.5	Gjirokastër
20	Diga e rezervuarit Helmës, Korçë	6	Korçë
21	Diga e rezervuarit Spitallë 2, Durrës	1	Durrës
22	Diga e rezervuarit Shkallnur, Durrës	1	Durrës
23	Diga e rezervuarit Likesh, Durrës	1	Durrës
24	Diga e rezervuarit Çizmeli, Durrës	1	Durrës
25	Diga e rezervuarëve Memaj, Arapaj, Vrion, Durrës	1	Durrës
26	Diga e rezervuarit Shishtavec, Kukës	5	Kukës
27	Diga e rezervuarit Pla, Kukës	8	Kukës
28	Diga e rezervuarit Stropcke, Pogradec	2	Pogradec
29	Diga e rezervuarit Seferaj, Kavajë	8	Kavajë
30	Diga e rezervuarit Hajdaraj, Kavajë	1	Kavajë
31	Diga e rezervuarit Zhabjak, Kavajë	2	Kavajë
32	Diga e rezervuarit Beden, Kavajë	2	Kavajë
33	Diga e rezervuarit Pekisht, Kavajë	1	Kavajë
34	Diga e rezervuarit Divjakë, Lushnjë	2.5	Lushnjë
35	Diga e rezervuarit Manasufaj, Lushnjë	3.5	Lushnjë
36	Diga e rezervuarit Spolate, Lushnjë	2	Lushnjë
37	Diga e rezervuarit Ardenicë, Lushnjë	2	Lushnjë
38	Diga e rezervuarit Fier-Seman, Lushnjë	2	Lushnjë
39	Diga e rezervuarit Dushk, Lushnjë	2.5	Lushnjë
40	Diga e rezervuarit Posnovisht, Elbasan	6	Elbasan
41	Diga e rezervuarit Plangaricë, Elbasan	1.5	Elbasan
42	Diga e rezervuarit Kashtë, Elbasan	2	Elbasan
43	Diga e rezervuarit Marinë, Elbasan	1.5	Elbasan
44	Diga e rezervuarit Rajc, Elbasan	1	Elbasan
45	Diga e rezervuarit Zaranikë, Elbasan	5	Elbasan
46	Diga e rezervuarit Xherie, Elbasan	5	Elbasan
47	Diga e rezervuarit Harvala, Vlorë	1	Vlorë
48	Diga e rezervuarit Malaj 1+2, Lezhë	8	Lezhë
49	Diga e rezervuarit Trojza, Lezhë	6	Lezhë
50	Diga e rezervuarit Perlat, Lezhë	3	Lezhë
51	Diga e rezervuarit Kashnjet, Lezhë	2	Lezhë
52	Diga e rezervuarit Kallmet, Lezhë	2.5	Lezhë
53	Diga e rezervuarit Trashan, Lezhë	2	Lezhë
	Totali	**229**	

VENDIM
Nr.174, datë 18.3.2010

PËR PJESËMARRJE NË OPERACIONIN USHTARAK NTM-I (NATO TRAINING MISSION IRAQ)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision, në operacionin ushtarak NTM-I (NATO Training Mission Iraq), të dy ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Misioni është edukimi dhe trajnimi i personelit të forcave të sigurisë irakiane, pranë komandës irakiane të stërvitjes.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është 2 (dy) vjet.

4. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet, përkatësisht, për:

- shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 9000 (nëntë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
- akomodimin (fjetje, ngrohje, ujë);
- ushqimin;
- energjinë elektrike dhe lavanterinë;
- qiranë e magazinimit;
- karburantin;
- evakuimin mjekësor;
- siguracionin, mirëmbajtjen dhe riparimet e automjetit, siguracionin shëndetësor, telefoninë fikse dhe të lëvizshme, përkthyesin;
- çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.177, datë 10.3.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "SEVASTI & PARASHQEVI QIRIAZI", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 26, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në shkollën e lartë private "Sevasti & Parashqevi Qiriazi", Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të tretë, "Master i nivelit të dytë" (MND), në formën e studimit me kohë të plotë, në:

a) financë,
b) kontabilitet,
c) marketing.

2. Këto programe studimi të ciklit të tretë realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë "Master i nivelit të dytë" (MND), në:

d) financë,
e) kontabilitet,
f) marketing.

3. Shkolla e lartë private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”, Tiranë, të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.178, datë 10.3.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “KRISTAL”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 26, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në shkollën e lartë private “Kristal”, Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të parë, “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në formën e studimit me kohë të plotë, në:

a) Harqe (violinë, violë, violonçel, kontrabas);

b) Instrumente fryme (flaut, oboe, klarinetë, trombë, korno, trombon, tuba, saksofon, korno angleze);

c) Piano;

ç) Kitarë;

d) Harpë;

dh) Fizarmonikë;

e) Perkusion;

ë) Art vokal (kanto klasike, kanto moderne);

f) Kompozicion;

g) Dirigjim;

gj) Tekstil mode.

2. Këto programe studimi, të ciklit të parë, realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tre) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

a) Harqe (violinë, violë, violonçel, kontrabas);

b) Instrumente fryme (flaut, oboe, klarinetë, trombë, korno, trombon, tuba, saksofon, korno angleze);

c) Piano;

ç) Kitarë;

d) Harpë;

dh) Fizarmonikë;

e) Perkusion;

ë) Art vokal (kanto klasike, kanto moderne);

f) Kompozicion;

g) Dirigjim;

gj) Tekstil modë.

3. Shkolla e lartë private “Kristal”, Tiranë, të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.181, datë 17.3.2010

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT DHE PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT QENDROR TË REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 201, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni Qendror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore kryesohet nga Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe në përbërje ka këta anëtarë:

a) Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes të Konsumatorit;

b) Ministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;

c) Ministrin e Brendshëm;

ç) Drejtorin e Përgjithshëm të Institutit të Statistikave;

d) Drejtorin e Drejtorisë së Statistikave Ekonomike në INSTAT;

dh) Kryeregjistruesin e Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë;

e) Drejtorin e Departamentit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj në Kryeministri;

ë) Drejtorin e Përgjithshëm të Politikave Bujqësore pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes të Konsumatorit;

f) Drejtorin e Përgjithshëm të Blegtorisë pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes të Konsumatorit;

g) Rektorin e Universitetit Bujqësor të Tiranës.

2. Komisioni Qendror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore mblidhet në javën e fundit të çdo muaji. Mbledhjet e tij kryesohen nga kryetari i komisionit e, në mungesë të tij, nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes të Konsumatorit. Mbledhjet e këtij komisioni do të zhvillohen në selinë e Kryeministrisë.

3. Në mbledhjet e komisionit, veç anëtarëve, marrin pjesë edhe specialistët e nevojshëm sipas specifikës së çështjes, që do të diskutohet, dhe vendimit që është marrë paraprakisht nga Komisioni Qendror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore.

4. Rendi i ditës për mbledhjen e radhës së Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it.

Thirrja e mbledhjeve kryhet me anë të një njoftimi, i cili duhet t'i transmetohet çdo anëtari të komisionit jo më vonë se 7(shtatë) ditë përpara ditës së përcaktuar në njoftimin për mbledhje. Në njoftim përcaktohen data, ora e mbledhjes dhe rendi i ditës. Njoftimi shoqërohet me materialet, që do të shqyrtohen në mbledhje, të përgatitura nga sekretariati i komisionit, pasi të jetë marrë, paraprakisht, miratimi nga kryetari i këtij komisioni.

5. Mbledhjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore e deklaron të hapur kryetari i komisionit, pasi ka verifikuar nëse në mbledhje marrin pjesë mbi 50% e anëtarëve. Për të gjitha çështjet, që diskutohen në mbledhje, vendoset me votim me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

6. Për çdo mbledhje të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore mbahet procesverbal, i cili zbardhet nga sekretariati i komisionit brenda pesë ditëve nga data e mbledhjes. Në procesverbal përcaktohen, ndërmjet të tjerave:

- numri dhe tematika e mbledhjes;
- data, koha e fillimit dhe e mbylljes së mbledhjes;
- emri i drejtuesit dhe i sekretarit të mbledhjes;
- emrat e anëtarëve të pranishëm;
- rendi i ditës;
- rezultatet e votimit.

7. Detyrat dhe kompetencat e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore janë të përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr.10 201, datë 17.12.2009.

8. INSTAT-i ngarkohet me detyrën e sekretariatit të komisionit dhe ka këto detyra:

- Njoftimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, për mbledhjen e radhës;
- Mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes;
- Përgatitjen e dokumentacionit bazë të mbledhjes;
- Përgatitjen dhe dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm, për mbledhjet komisionit, kryetarit të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore.
- Njoftimin e shpërndarjen e rendit të ditës, të projektakteve që do të shqyrtohen dhe të dokumentacionit, për mbledhjen e radhës, anëtarëve, brenda dy ditëve nga data e nënshkrimit nga kryetari;
- Mbajtjen e kopjeve të dokumentacionit, që do të shqyrtohet në mbledhje, dhe vendosjen e tij në dispozicion të anëtarëve;
- Përgatitjen e projektit të procesverbalit, të projektvendimeve të marra në mbledhje dhe ndjekjen e procedurave të miratimit e të arkivimit të tij;
- Përgatitjen e vendimeve që do të merren, në përputhje me rendin e ditës, të cilat ia bashkëngjit procesverbalit, të nënshkruar nga anëtarët.

9. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.182, datë 10.3.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 686, DATË 18.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN E DREJTËSISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.686, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Kuotat e pranimit në këto programe studimi të doktoratës, në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2009-2010, janë, gjithsej, 100, prej të cilave 19 për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë vendit. Ndarja e këtyre kuotave sipas programeve të studimeve, është, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në "Shkenca juridike civile" 32 kuota;
b) Doktoratë në "Shkencat penale" 32 kuota;
c) Doktoratë në "E drejta publike" 36 kuota.".

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.".

c) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.183, datë 10.3.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.71, DATË 3.2.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2010, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.71, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, në njësitë e qeverisjes qendrore, është 753 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Përjashtimisht, për Institutin e Statistikës nuk zbatohet paragrafi 2 i pikës 2 të vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 "Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme, për ministritë dhe institucionet buxhetore". Numri i punonjësve për realizimin e veprimtarive statistikore, afatet kohore dhe të tjera specifikime lidhur me punonjësit e Institutit të Statistikës, të përcaktohen nëpërmjet një udhëzimi të përbashkët të drejtorit të përgjithshëm të INSTAT-it dhe Ministrit të Financave.

3. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin e vitit 2010, të njësive të qeverisjes qendrore.

4. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë përcaktimin e numrit të punonjësve, sipas lidhjes nr.1, të përmendur në pikën 1, në përputhje me kriteret e vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 "Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme, për ministritë dhe institucionet buxhetore".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Emri i institucionit	**Nr. punonjësve**	**Emërtesa**	**Koha mesatare**	**Muajt**
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	19			
Aparati i ministrisë	1	Sanitare	deri 3 orë/ditë	vjetore
Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	1	Operatore	deri 5 orë/ditë	vjetore
Inpektorati Qendror Teknik	1	Sanitar	deri 3 ore/ditë	vjetore
Inpektorati Qendror Teknik	1	Laboratorë	deri 5orë/ditë	vjetore
ALBINVEST	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
Shërbimi Gjeologjik	2	Punëtor shpimi	3-5 orë/ditë	vjetore
Shërbimi Gjeologjik	1	Punëtor rilevimi	3-5 orë/ditë	vjetore
Shërbimi Gjeologjik	11	Nëpunës roje	8 orë/ditë	5 muaj
Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	502			vjetore
ALUIZNI	500	Specialistë/ndihmës specialistë	8 orë/ditë	vjetore
Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizimeve	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
IQT	1	Sanitar	deri 4 orë/ditë	vjetore
Ministria e Financave	28			
Sektori i pagesave të dëmshpërblimeve	4	Specialistë	8 orë/ditë	6 muaj
Sektori i pagesave të dëmshpërblimeve	1	Punonjës arkivi	8 orë/ditë	6 muaj
Drejtoria e Financimeve, Kontraktimeve /dega thesar	1	Roje	8 orë/ditë	6 muaj
Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
Degët e thesarit	7	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	4	Operatore	deri 4 orë/ditë	vjetore
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
Dogana Elbasan	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 ore/ditë	vjetore
Dogana Morinë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
Dogana Shkodër	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
Dogana Kakavijë, Gjirokastër	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
Dogana Vlorë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
Dogana Tiranë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
Dogana Tushemisht	1	Sanitare	3-4 orë/ditë	vjetore
Dogana Qafë-Thanë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
Dogana Tre- Urat Përmet	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	6			
ZAK Butrint	5	Ciceronë	8 orë/ditë	4.5 muaj
ZAK Butrint	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	8 orë/ditë	4.5 muaj
Ministria e Shëndetësisë	6			
Spitali Psikiatrik Elbasan	3	Kaldajistë	8 orë/ditë	4.5 muaj
Drejtoria e Shëndetit Publik Vlorë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	Mars-Dhjetor
Drejtoria e Shëndetit Publik Peqin	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	Mars-Dhjetor
Drejtoria e Shëndetit Publik Has	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	Mars-Dhjetor
Ministria e Jashtme	10			
Aparati i ministrisë	2	Punëtorë mirëmbajtjeje	6 orë/ditë	vjetore
Sektori i legalizimeve	5	Preparatorë	6 orë/ditë	vjetore
Sektori i arkivit	3	Arkivistë	6 orë/ditë	vjetore
Ministria e Brendshme	128			
Aparati	1	Specialist përkthyes	8 orë/ditë	6 muaj
Aparati	2	Teknikë	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	2	Kuzhiner	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	4	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	2	Kamerierë	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Punëtorë restoranti	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	4	Punëtorë hoteli	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Recepsionist	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Elektricist	8 orë/ditë	6 muaj

Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Hidraulik	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Punëtor gjelbërimi	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Lavanteri	8 orë/ditë	6 muaj
Shtëpia e Pushimit Durrës	4	Kuzhinier	8 orë/ditë	1 qershor-10 Shtator
Shtëpia e Pushimit Durrës	4	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	1 qershor-10 Shtator
Shtëpia e Pushimit Durrës	27	Kamerierë	8 orë/ditë	1 qershor-10 Shtator
Shtëpia e Pushimit Durrës	7	Punëtorë kuzhine	8 orë/ditë	1 qershor-10 Shtator
Shtëpia e Pushimit Durrës	7	Punëtorë restoranti	8 orë/ditë	1 qershor-10 Shtator
Shtëpia e Pushimit Durrës	25	Punëtorë hoteli	8 orë/ditë	1 qershor-10 Shtator
Shtëpia e Pushimit Durrës	3	Recepsionist	8 orë/ditë	1 qershor-10 Shtator
Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Elektricist	8 orë/ditë	1 qershor-10 Shtator
Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Hidraulik	8 orë/ditë	1 qershor-10 Shtator
Shtëpia e Pushimit Durrës	2	Punëtorë gjelbërimi	8 orë/ditë	1qershor-10 Shtator
Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Lavanderi	8 orë/ditë	1 qershor-10 Shtator
Rezervat Materiale të Shtetit	20	Roje	8 orë/ditë	6 muaj
Rezervat Materiale të Shtetit	5	Punëtorë magazine	8 orë/ditë	6 muaj
Shërbimi Informativ i Shtetit	2			
Shërbimi Informativ i Shtetit	5	Sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
Shërbimi Informativ i Shtetit	1	Sanitar	3-4 orë/ditë	6 muaj
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	10			
Aparati	10	Administratorë dokumentesh	5 orë/ditë	vjetore
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	35			
Aparati	4	Roje	8 orë/ditë	4 muaj
Foshnjës/Fëmijëve/Moshuarve/Qendrat e Zhvillimit/Qendrat Pritëse dhe Ditore	21 10	Mjekë Sanitar	deri 4 orë/ditë deri 4 orë/ditë	vjetore vjetore
Prokuroria e Përgjithshme	5			
Aparati	2	Përkthyes	5 orë/ditë	vjetore
Prokuroria Tiranë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
Prokuroria Durrës	1	Sanitar	3- 4 orë/ditë	vjetore
Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda	1	Sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
Autoriteti i Konkurrencës	2			
Autoriteti i Konkurrencës	1	Teknik mirëmbajtjeje	5 orë/ditë	vjetore
Autoriteti i Konkurrencës	1	Sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
Total numri i punonjësve	**753**			

UDHËZIM
Nr.423, datë 24.2.2010

PËR KRITERET E PËRDORIMIT TË FONDIT TË PASHPËRNDARË TË MBROJTJES SOCIALE

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, në ligjin nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2010" dhe në zbatim të pikës 81 të udhëzimit nr.1, datë 21.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2010"

UDHËZOJ:

1. Fondi i pashpërndarë i mbrojtjes sociale përdoret për mbështetjen me fonde të rasteve të paparashikuara për:

a) familje apo individë në nevojë në raste fatkeqësish me vdekje nga aksidente në punë, sëmundje të rënda, fatkeqësi nga zjarri, përmbytje apo fatkeqësi të tjera natyrore.

b) njësitë vendore për programimin e ndihmës ekonomike, pagesën për aftësinë e kufizuar, për plotësimin e nevojave të paparashikuara dhe emergjente, si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur në nivelin e varfërisë së familjeve banuese në juridiksion të territorit të tyre, ndryshimit të nivelit të papunësisë dhe punësimit.

c) shërbimet sociale komunitare, që ofrohen në qendra rezidenciale, ditore, shërbime në shtëpi, shërbimin e kujdestarisë, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, të rinjve dhe grave në nevojë.

2. Për shpërndarjen e fondeve, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, krijohet një komision me 5 anëtarë. Komisioni kryesohet nga Ministri dhe anëtarët e tij janë Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Politikave, Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Shërbimeve Sociale dhe përgjegjësi i sektorit të planifikimit financiar.

3. Komisioni mblidhet periodikisht dhe vlerëson kërkesat që vijnë nga njësitë vendore, për mbështetjen e individëve, familjeve, grupimeve që konsiderohen në nevojë dhe i paraqet ministrit propozimin për shpërndarjen e këtij fondi.

4. Njësitë e qeverisjes vendore, bashkitë dhe komunat paraqesin projektet dhe propozimet e tyre për mbështetje nga fondi i pashpërndarë i mbrojtjes sociale sipas germave "a", "b" dhe "c" të pikës 1, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. Kërkesat për shërbimet sociale komunitare, germa "c" e pikës 1, bëhen sipas modularit 1,bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror bën vlerësimin e kërkesave të ardhura nga njësitë vendore.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror në vlerësimin e bërë propozon edhe nivelin e financimit të projektit dhe mendimin e saj me shkrim, së bashku me projektet e propozuara, i përcjell në komisionin e MPÇSSHB për shqyrtim e miratim.

6. Sektori i planifikimit financiar bën vlerësimin e nivelit të financimit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe i propozon komisionit masën e financimit të projektit.

7. Kërkesat për mbështetje nga fondi i pashpërndarë i mbrojtjes sociale që paraqesin njësitë e qeverisjes vendore mbështeten dhe argumentohen me:

a) Treguesit e nivelit të varfërisë që kanë njësitë vendore sipas vlerësimeve të LSMS dhe kritereve të ndihmës ekonomike;

b) Vlerësimin e nevojave për shërbime sociale në territorin e tyre;

c) Nivelin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror që ofrohen aktualisht nga subjektet publike dhe jopublike në njësitë vendore;

d) Numrin e përfituesve të shërbimit, nivelin e zbatimit të standardit të shërbimeve për përfituesit në nevojë dhe performancën e mëparshme të shërbimit;

e) Kontributin e njësisë vendore në mjete financiare ose në kapitale të trupëzuara të vëna në dispozicion të ofrimit të shërbimit social, për të cilin kërkohet financim;

f) Treguesit, përfitues në ndihmë ekonomike, persona me aftësi të kufizuara, personat pjesëtarë të familjeve ku nëna është kryefamiljare, persona pjesëtarë në grupet në nevojë, pjesëtarë të familjeve rome, jetimët familjarë për individët që do të përfitojnë mbështetje financiare;

g) Mosparashikimin e financimit të shërbimit të përkujdesit shoqëror, në vitin ushtrimor buxhetor.

8. Mbështetja nga fondi i pashpërndarë i mbrojtjes sociale për shërbimet sociale rezidenciale apo komunitare, të paparashikuara, për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, të rinjtë dhe gratë në nevojë, bëhet vetëm për ushqimin, pagat dhe sigurimet shoqërore të profesionistëve që ofrojnë drejtpërsëdrejti shërbime me klientët, si: edukator, punonjës social, psikolog, mjek, infermier.

9. Të gjitha shpenzimet e tjera të nevojshme për funksionimin e shërbimeve sociale komunitare për personelin administrativ dhe shpenzimet operative, si energji, ujë, ushqim, kancelari etj. mbulohen nga vetë njësia vendore.

10. Fondi i miratuar për shërbimet sociale nga komisioni, delegohet si transfertë e kushtëzuar në njësitë e qeverisjes vendore, nga MPÇSSHB.

11. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë të drejtë të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të këtij fondi.

12. Njësitë e qeverisjes vendore ndjekin procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi për përzgjedhjen e ofruesit të shërbimit sipas germës “c” të pikës 1 të këtij udhëzimi, fitues i projektit të miratuar nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

13. Këshilli i Bashkisë ose Komunës merr vendim për përdorimin e këtij fondi, për qëllimin që është dhënë, së bashku me kontributin e njësisë së qeverisjes vendore.

14. Për raportimin e realizimit të përdorimit të fondit, të ndiqet e njëjta procedurë si veprohet për programin e ndihmës ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar.

15. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të paraqesin treguesit statistikorë për shërbimet shoqërore sipas legjislacionit në fuqi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

Modulari 1
PROJEKTPROPOZIM OSE PROJEKT PËR SHËRBIMET SOCIALE

1.Vlerësimi i propozimit të projektit

1.1 Titulli i projektit

1.2 Bashki komunë

1.3 Kohëzgjatja e projektit në muaj

1.4 Kosto e propozuar për t'u financuar nga fondet buxhetore

1.5 Kontributi i njësisë vendore (lekë)

1.6 Kontribute të tjera (lekë) ndërtesa, staf, pagesa nga përfituesit etj.

1.7 Buxheti total (lekë)

1.8 Numri i vlerësuar i përfituesve direkt

1.9 Kosto e vlerësuar për një përfitues/klient (lekë)

1.10 Tipologjia e shërbimeve

	Qendra ditore		Shërbim në familje		Qendra multidisiplinare		Qendra informacioni dhe këshillimi
	kujdestari		Strehëza të përkohshme		Të tjera		

1.11 Problematika që do të adresojë projekti i propozuar

1.12.Grupet e adresuara:

1.13 Fillimi i projektit: data_____ muaji_____

1.14 Përfundimi i projektit: data_____ muaji_____

2. Informacion i përgjithshëm mbi projektin

2.1 Emri i projektit:

2.2 Bashkia/komuna

2.3 Gjendja e shërbimit: ☐ Ekzistues ☐ I ri

2.4 Gjendja e infrastrukturës ☐ Rehabilitim ☐ I ri ☐ Zgjerim

2.5 Qarku ku bën pjesë:

2.6 Përshkruani shkurt vendin e zbatimit të projektit:

3. Shërbime ekzistuese[1]

3.1 Përshkruani tipin e shërbimit të ofruar nga pushteti qendror, pushteti lokal, OJF apo qendra komunitare dhe numrin e përfituesve të këtij shërbimi.

Tipin e shërbimit/ grupi i adresuar	**PAK**	**Fëmijë në risk**	**Të rinj në risk**	**Gra dhe familje në risk**	**Të moshuar në risk**	**Të tjerë**
Institucion rezidencial						
Qendër ditore						
Shërbim komunitar						
Shkolla						
Qendra shëndetësore						
Programe parandaluese						
Diagnostikim i hershëm						
Qendra multidisiplinare						
Strehëza të përkohshme						
Qendra informimi dhe këshillimi						
Shërbim në familje						
Kujdestari						
Të tjera						

3.2 Përshkruani perceptimin/ndjesinë e klientëve apo përfituesve ndaj cilësisë së shërbimit të ofruar

_____
_____
_____
_____
_____

[1] Ky seksion vlerëson eksperiencën e bashkisë/komunës me qëllim vlerësimin e kapaciteteve potenciale për të zbatuar projektin e propozuar.

3.3 Staf administrativ (përshkruaj)_____
_____
_____

3.4 Numri i përfituesve direktë:	
3.5 Numri i stafit administrativ:	
3.6 Numri i stafit profesionist:	
3.7 Raporti staf i përgjithshëm/përfitues	
3.8 Raporti staf profesionist/përfitues:	

4. Shërbimet e mëparshme dhe shërbimet aktuale të ofruara për këtë target grup

Lloji i shërbimit	**Nr. i përfituesve**	**Periudha vite**	**Kostoja**	**Burimi i financimit**

4.1 Eksperienca e bashkisë/komunës/OJF

Emri i bashkisë/komunës/OJF	**Shërbimi i ofruar nga bashkia/komuna OJF**	**Periudha**

5. Prezantimi i problemit

5.1 Tregoni problemin që do të adresojë nënprojekti

_____
_____
_____

6. Qëllimi dhe objektivi

6.1 Qëllimi i projektit

_____
_____
_____
_____

6.2 Objektivat e projektit, aktivitetet dhe rezultatet e projektit

Objektivat e projektit	**Indikatorët**	**Mjetet e verifikimit**	**Rreziqet/supozime**

6.3 Rezultatet e pritshme

Rezultati	Grupi target	Nr. i përfituesve direkte	Nr. i përfituesve indirekte	Qarku i targetuar

7.Qëndrueshmëria e projektit

7.1 Listoni kostot për stafin profesionist që do të mbulohen nga fondet e buxhetit qendror dhe kostot operative për 3 vitet e ardhshme që do të mbulohen me fondet e bashkisë/komunës.

Kosto	Burimi potencial i financimit	Shuma (lekë)
1. Fondet nga buxheti qendror	MPÇSSHB	
1.1 Pagat dhe sigurimet shoqërore për stafin profesionist		
1.2 Kosto për ushqimin për rastet e qendrave rezidenciale		
1.3 Shërbime konsulence (trajnime)		
2. Fondet nga buxheti lokal	Bashki/komunë	
2.1 Pagat e stafit administrativ		
2.2 Shpenzime operative Uji Elektriciteti Telekomunikacioni Ngrohje		
2.3 Mirëmbajtja dhe operacionet		
2.4 Qira		
2.4 Transporti dhe mirëmbajtja		
2.5 Të tjera		
3. Fonde nga donatorë		
3.1 Donatori		
Nëntotali i kostos operative		
TOTALI		

7.2 Listoni stafin që nevojitet për të ofruar shërbimin

Specialiteti i stafit	Numri i stafit	Pagat në total	Stafi rezistent ose që do të rekrutohet

7.3 A do të ketë pagesë nga klienti ☐ Po ☐ Jo

7.4 Ju lutem përshkruani skemën e pagesës nga klienti

_____
_____
_____
_____

8. Zbatimi i projektit

8.1 Aktivitetet e kërkuara për zbatimin e projektit

Nr.	Aktiviteti	Kohëzgjatja (në muaj)	Personi ose njësia përgjegjëse

8.2 Cila është kohëzgjatja totale e projektit

9. Plani i monitorimit dhe indikatorët

Ju lutem vendosni tabelën e matësve të indikatorëve, mënyrat edhe kalendarin e verifikimit

Indikatorët e performancës	Mekanizmat e mënyrës së verifikimit/raportimit	Kalendari

10. Miratimi dhe konfirmimi

Emri _____ Pozicioni _____
Firma _____ Data _____

Emri _____ Pozicioni Përfaqësuesi i bashkisë/komunës
Firma _____ Data _____

UDHËZIM
Nr.2007/1, datë 2.3.2010

PËR RASTET KUR NOTERËT KËRKOJNË INFORMACION TË SHKRUAR MBI TË DHËNAT E REGJISTRIT TË BARRËVE SIGURUESE DHE PROCEDURAT QË NDIQEN NË KËTO RASTE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të paragrafit 3 të nenit 28/1 dhe 26/ë të ligjit nr.8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", të ndryshuar dhe të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë", të ndryshuar, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZOJNË:

1. Noterët kërkojnë informacion të shkruar mbi të dhënat e "Regjistrit të barrëve siguruese" përpara kryerjes së transaksioneve të parashikuara në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

2. Procedurat që ndiqen për paraqitjen e kërkesës për informacion nga noterët dhe kthimin e përgjigjes nga kryeregjistruesi i barrëve siguruese janë ato të parashikuara në rregulloren për barrët siguruese, miratuar me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr.493, datë 6.7.2006 "Për miratimin e rregullores së barrëve siguruese".

3. Noterët kërkojnë informacion nga të dhënat e regjistrit nëpërmjet plotësimit të formularit, njoftimi D-kërkesa për informacion, në përputhje me nenin 3 të rregullores për barrët siguruese, i cili nënshkruhet nga vetë noteri ose një person i autorizuar prej tij.

4. Kryeregjistruesi i barrëve siguruese, brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës, lëshon certifikatën, e cila përmban të dhënat aktive të ruajtura në regjistër, të parashikuara në rregulloren për barrët siguruese dhe të nevojshme për transaksionin.

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen noterët, strukturat përgjegjëse për aktivitetin e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe strukturat përgjegjëse për administrimin e regjistrit të barrëve siguruese në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Dritan Prifti

ANEKSI NR.1

LISTA E TRANSAKSIONEVE PËR TË CILAT NOTERËT KANË DETYRIMIN TË KËRKOJNË INFORMACION NË REGJISTRIN E BARRËVE SIGURUESE.

1. Transaksione me objekt mallra me numër serie

Në këtë kategori përfshihen mallrat sipas përkufizimit të tyre në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar ("a", "b", "c", "d", "f", "h", "i") dhe rregulloren për barrët siguruese ("dh", "e", "g"), si më poshtë:

a) automjete;
b) ciklomotorë;
c) makina bujqësore;
d) makina teknologjike;
dh) mjete fluturimi;
e) mjete lundrimi;
f) motomjete;
g) motorë mjet fluturimi;
h) rimorkio;
i) trolejbusë.

2. Kontrata me objekt rikonstruksion dhe sistemim;
3. Transaksione me objekt pajisje shtëpie (në të tashmen dhe të ardhmen);
4. Transaksione me objekt pajisje biznesi (në të tashmen dhe të ardhmen);
5. Transaksione me objekt mallra konsumi;
6. Transaksione me objekt gjendjen e mallit;
7. Transaksione me objekt mjete të ndryshme shërbimi;
8. Transaksione me objekt aksionet e një kompanie;
9. Kontratë qiraje me afat mbi një vit;
(në kuptim të nenit 2 të ligjit nr.8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", të ndryshuar)
10. Kontratë komisioni të mallrave;
(në kuptim të nenit 2 të ligjit nr.8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", të ndryshuar)

11. Kontratë shitje apo cedimi të llogarive;

(në kuptim të nenit 2 të ligjit nr.8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", të ndryshuar)

12. Kontratë e shitjes me rezervë të mallrave;

(në kuptim të nenit 2 të ligjit nr.8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", të ndryshuar)

13. Kontratë posedimi;

14. Kontratë furnizimi;

15. Kontratë shërbimi;

16. Kontratë sipërmarrje, sidomos kontratat e sipërmarrjes së apartamenteve apo shtëpive deri në momentin e regjistrimit të tyre në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

17. Kontrata që përmbajnë transferimin e titullit të pronësisë;

18. Depozitë bankare, së bashku me interesat

19. Transaksione të tjera të çdo forme apo emërtimi, që krijojnë barrë siguruese mbi sende të luajtshme ose pasuri të paprekshme apo mbi të drejtat e pronarit me anë të transferimit të titullit të pronësisë, posedimit me anë pengu apo me çdo mënyrë tjetër.

VENDIM
Nr.13, datë 10.3.2010

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHTESË NGA BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a", nenit 43, shkronjat "c" dhe "e", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja "ç", nenit 54, pika 2 shkronja "e" dhe nënpika "i", të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të nenit 45 të ligjit nr.9879, datë 21.2.2008 "Për titujt", me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen, nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

"- Ndërmjetësimi për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit.".

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës së Parë të Investimeve, Albania sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohen Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 14.4.2010
Doli nga shtypi më 15.4.2010

Tirazhi: 3000 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë